



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.127

29 gusht

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i BSH
nr.61, datë 29.7.2009

Për miratimin e rregullores “Për transaksionet me titujt
ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit
të titujve” 5969

Kërkesë e MPPTT
nr.2753/2, datë 27.7.2009

Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të
paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i
segmentit rrugor “Shkodër-Hani i Hotit” 5987

VENDIM
Nr.61, datë 29.7.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR TRANSAKSIONET ME TITUJT NDËRMJET BANKAVE DHE FUNKSIONIMIN E
SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË TITUJVE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “ç”, të nenit 3, pika 2, pika 4, shkronja “d”, të nenit 14, të nenit 25, pika 2, të nenit 29, të nenit 43, shkronja “c”, të nenit 53, paragrafi i fundit të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”; të nenit 31 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”; të marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit në dy nivele”, datë 5.9.2006, të ndryshuar; të marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, datë 28.9.2007, të ndryshuar; të nenit 3, shkronja “d” të rregullores “Kushtet e përgjithshme të punës të Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.103, datë 29.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; të nenit 3 të rregullores “Mbi kushtet e veçanta të punës të Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.17, datë 26.2.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për transaksionet me titujt ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Të autorizojë Drejtorin e Departamentit të Operacioneve Monetare të nënshkruajë kontratat tip për pjesëmarrjen në sistemin e regjistrimit të titujve, të përcaktuar në aneksin nr. 1, pjesë përbërëse e rregullores.

3. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Sistemeve të Pagesave dhe Departamenti i Teknologjisë së Informacionit në Bankën e Shqipërisë, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja “Mbi tregun sekondar ndërbankar të letrave me vlerë të Qeverisë të Republikës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.84, datë 16.11.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

RREGULLORE
PËR TRANSAKSIONET ME TITUJT NDËRMJET BANKAVE DHE FUNKSIONIMIN E
SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË TITUJVE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

Qëllimi i kësaj rregulloreje është nxitja dhe mbështetja e veprimtarisë ndërmjet bankave për transaksionet me titujt dhe e funksionimit të sistemit të regjistrimit të titujve, nëpërmjet përcaktimit të:

- a) kushteve për kryerjen e transaksioneve me titujt ndërmjet bankave nëpërmjet sistemit të regjistrimit të titujve pranë Bankës së Shqipërisë;
- b) kushteve dhe procedurave që ndiqen për pjesëmarrjen/çeljen e llogarisë së titujve në sistemin e regjistrimit të titujve pranë Bankës së Shqipërisë; dhe
- c) kushteve dhe procedurave që ndiqen për klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve me titujt në tregun sekondar, me qëllim eliminimin e rrezikut principal.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen ndaj:

- a) bankave; dhe
- b) pjesëmarrësve të tjerë jobanka, në sistemin e regjistrimit të titujve.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”; të ndryshuar;
- b) ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- c) ligjit nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt”;
- d) ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”;
- e) marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë i bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit në dy nivele”, datë 5.9.2006, të ndryshuar;
- f) marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, datë 28.9.2007, të ndryshuar;
- g) rregullores “Kushtet e përgjithshme të punës së Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 103, datë 29.12.2001 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; dhe
- h) rregullores “Mbi kushtet e veçanta të punës së Bankës së Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.17, datë 26.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

1. Në zbatim të kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Tituj” janë vetëm titujt e shtetit shqiptar dhe konkretisht: bonot e thesarit dhe obligacionet shtetërore të emetuara nga Ministria e Financave në përputhje me ligjin nr.9665, datë 5970

18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”; ligjin nr.9879, datë 21.2.2008 “Për titujt” dhe aktet e tjera nënligjore.

b) “Bono e thesarit” është një titull afatshkurtër borxhi, me afat maturimi jo më të gjatë se një vit nga data e emetimit.

c) “Obligacion shtetëror” është një titull afatgjatë borxhi, me afat maturimi më të gjatë se një vit nga data e emetimit.

d) “Treg primar” nënkupton hapësirën fizike ose funksionale në të cilin shteti shqiptar emeton për herë të parë titujt. Ankandet e tregut primar të titujve shtetërorë organizohen nga Banka e Shqipërisë.

e) “Treg sekondar” nënkupton hapësirën fizike ose funksionale ku kryhen transaksionet me titujt, pasi ato janë emetuar së pari në tregun primar.

f) “Bankat” janë subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë, përfshirë degët e bankave të huaja, sipas ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

g) “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, i krijuar me ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

h) “DOM” është Departamenti i Operacioneve Monetare i Bankës së Shqipërisë.

i) “Ankand” është ankandi i zhvilluar nga Banka e Shqipërisë për shitblerjen e titujve të emetuara nga shteti shqiptar.

j) “Llogari rrjedhëse” është llogaria në *cash*, që bankat, degët e bankave të huaja, si dhe klientët të tjerë me status të veçantë, kanë pranë Bankës së Shqipërisë.

k) “Llogari e titujve” është llogaria në sistemin e regjistrimit të titujve pranë Bankës së Shqipërisë, e cila përdoret për emetimin, mbajtjen e titujve dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga transaksionet me titujt ndërmjet pjesëmarrësve në sistem.

l) “Sistemi i regjistrimit të titujve” nënkupton sistemin që krijon dhe mban Banka e Shqipërisë për regjistrimin e titujve të emetuar nga shteti shqiptar, sipas përcaktimit të nenit 31 të ligjit “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”.

m) “Regjistër” nënkupton dokumentin zyrtar dhe ligjor ku evidentohen të dhëna mbi pronësinë e titujve, transaksionet e kryera me to apo të dhëna për vendosjen e tyre si garanci, që mbajnë shoqëritë aksionare (regjistrarë), të licencuara për këtë qëllim nga Autoriteti, sipas kërkesave të ligjit “Për titujt”.

n) “Data e shitblerjes (T)” nënkupton datën, në të cilën bankat dhe degët e bankave të huaja, të përfshira në transaksionet e shitblerjes së titujve pranojnë kushtet e tregtimit.

o) “Data e shlyerjes (T+2)” nënkupton si rregull datën, në të cilën transaksionet e shitblerjes së titujve evidentohen në llogaritë rrjedhëse dhe në llogaritë e titujve.

p) “Data e maturimit” është data në të cilën bëhet pagesa e vlerës nominale të titullit.

q) “Periudha e mbetur deri në maturim” nënkupton numrin e ditëve ndërmjet datës së shlyerjes dhe datës së maturimit të titullit.

r) “Ditë pune” nënkupton çdo ditë, përveç ditës së shtunë, të dielë dhe ditëve të festave zyrtare, në të cilën Banka e Shqipërisë kryen aktivitetin normal të saj.

s) “DVP” (*Delivery-versus-payment*) është parimi i komunikimit, midis sistemit të shlyerjes së titujve dhe sistemit të shlyerjes së *cash*-it, i cili nënkupton që në një transaksion shitblerje të titujve, transferimi i pronësisë së titujve, ndodh vetëm nëse pagesa *cash* është përfunduar paraprakisht.

t) “DFP” (*Delivery-free-payment*) nënkupton transferimin e pronësisë së titujve, pa një lëvizje fondesh të kryer paraprakisht.

u) “Rreziku principal” është rreziku që pala shitëse e titullit dorëzon pronësinë e titullit, por nuk merr/arkëton vlerën monetare të titullit ose rreziku që pala blerëse e titullit bën pagesën e vlerës monetare, por nuk merr pronësinë e titullit.

v) “Kleringu” është procesi i krahasimit dhe përlllogaritjes së detyrimeve reciproke të pjesëmarrësve në transaksionin e shitblerjes, në bazë neto ose për çdo transaksion, me qëllim shkëmbimin e titullit kundrejt vlerës monetare; dhe

w) “Shlyerja” është procesi i kompletimit/përfundimit të transaksionit të shitblerjes, ku pala shitëse transferon titullin te pala blerëse dhe kjo e fundit transferon vlerën monetare te pala shitëse. Shlyerja në sistemin e regjistrimit të titujve të shtetit mund të jetë me lëvizje fondesh, në përputhje me parimin DVP ose pa lëvizje fondesh, në përputhje me parimin DFP.

2. Titujt dhe krerët në këtë rregullore janë përdorur vetëm për orientim dhe referim, dhe nuk kanë për qëllim të kushtëzojnë ose të kufizojnë interpretimin e përcaktimeve dhe të dispozitave të kësaj rregulloreje.

3. Në këtë rregullore, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e nevojshme nga përmbajtja e dispozitës.

4. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore, dhe anasjelltas.

5. Për terma të tjerë që përdoren në këtë rregullore dhe nuk janë përkufizuar në këtë nen, vlejnë referencat e marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit në dy nivele”, datë 5.9.2006, e ndryshuar; dhe të marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, datë 28.9.2007, e ndryshuar.

KREU II TRANSAKSIONET ME TITUJT NDËRMJET BANKAVE

Neni 5

Llojet e transaksioneve me titujt

Transaksionet me titujt ndërmjet bankave janë si më poshtë:

- a) shitblerje e përkohshme dhe përfundimtare e titujve; dhe
- b) vendosje e titujve si kolateral për operacionet kredituese.

Neni 6

Kushtet për kryerjen e transaksioneve me titujt

1. Bankat mund të tregtojnë tituj, në sistemin e regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, vetëm duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) të kenë llogari rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë;
- b) të kenë llogari të titujve në Bankën e Shqipërisë;
- c) periudha e mbetur deri në maturimin e titullit, fillimi i së cilës llogaritet nga data e shlyerjes së transaksionit, të jetë jo më pak se 7 (shtatë) ditë pune; dhe
- d) titulli, objekt i shitblerjes, të mos jetë vendosur si kolateral në operacionet kredituese.

2. Bankat, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë të lira të negociojnë me njëra-tjetrën kushtet e tregtimit të titujve.

3. Bankat mund të hyjnë në një transaksion për vendosjen e titullit si kolateral për operacionet kredituese, vetëm nëse afati deri në maturim i titullit për vendosje si kolateral është jo më pak se afati i maturimit të vetë operacionit kreditues.

Neni 7

Njoftimi në datën e shitblerjes së titujve

Bankat, për transaksionet e shitblerjes së titujve ndërmjet tyre, në datën e tregtimit dhe/ose të kryerjes së transaksionit, njoftojnë pranë DOM-it, në lidhje me elementet e përcaktuara në aneksin nr. 3, nëpërmjet SWIFT-it, mjeteve të tjera të komunikimit elektronik të sigurt, ose me shkresë zyrtare, sipas përcaktimit që palët vendosin në kontratën për pjesëmarrjen në sistemin e regjistrimit të titujve.

KREU III SISTEMI I REGJISTRIMIT TË TITUJVE

Neni 8 **Pjesëmarrësit**

Subjektet që mund të hapin llogari të titujve në sistemin e regjistrimit të titujve, i cili mbahet nga Banka e Shqipërisë, janë si më poshtë:

- a) bankat;
- b) personat juridikë të licencuar nga Autoriteti për të kryer veprimtari të lidhur me transaksionet e titujve;
- c) Banka e Shqipërisë;
- d) Ministria e Financave; dhe
- e) institucionet e tjera financiare sipas përcaktimeve në marrëveshjet me Ministrinë e Financave.

Neni 9 **Kushtet për pjesëmarrje**

Subjektet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “e” të nenit 8 të kësaj rregulloreje, bëhen pjesëmarrëse në sistemin e regjistrimit të titujve, duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë të licencuara nga Autoriteti, në rastet kur licencimi kërkohet për subjektet e përcaktuara në shkronjën “b” të nenit 8 të kësaj rregulloreje;
- b) të kenë nënshkruar kontratën për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve me Bankën e Shqipërisë;
- c) të kenë një llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë ose në vijim të një marrëveshjeje me një bankë, të specifikojnë llogarinë rrjedhëse të bankës pranë Bankës së Shqipërisë, llogari e cila përdoret për të shlyer urdhërtransfertat e fondeve për transaksionet me titujt; dhe
- d) të kenë mundësi teknike komunikimi me sistemin e regjistrimit të titujve, me qëllim dërgimin/marrjen e urdhërtransfertave në lidhje me transaksionet me titujt në tregun sekondar. Format e komunikimit mund të jenë: SWIFT-i, mjete të tjera të komunikimit elektronik të sigurta ose me shkresa zyrtare, sipas përcaktimit të rënë dakord ndërmjet palëve në kontratën për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve.

Neni 10 **Dokumentacioni për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve**

Subjektet që aplikojnë për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve dërgojnë kërkesën për aplikim, sipas aneksit nr. 2 të rregullores, pranë DOM-it në Bankën e Shqipërisë, së cilës i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:

- a) një kopje e licencës së dhënë nga Banka e Shqipërisë, në rast se subjekti aplikues është bankë ose subjekt jobankë që kryen veprimtari financiare për të cilat licencohet nga Banka e Shqipërisë;
- b) një kopje e licencës së Autoritetit, në rast se subjekti aplikues licencohet nga Autoriteti për veprimtari tregtare me titujt apo si regjistrar i titujve;
- c) adresa SWIFT ose të dhëna mbi kodet e sigurisë/nënshkrimet elektronike të personave të autorizuar për të komunikuar nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit elektronik, dhe/ose specimenet e nënshkrimeve të personave të autorizuar për të kryer transaksione me titujt për subjektin, sipas shkronjës “d” të nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- d) numri i llogarisë së tyre rrjedhëse në sistemin AIPS; ose
- e) për subjektet që nuk kanë llogari rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë, një deklaratë nga banka, nëpërmjet së cilës banka jep miratimin/pëlqimin për shlyerjen e pagesave të subjektit nëpërmjet llogarisë së saj rrjedhëse në sistemin AIPS; dhe
- f) lista e personave të kontaktit.

Neni 11

Kontrata për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve

DOM-i shqyrton dokumentacionin e përcaktuar në nenin 10 të rregullores dhe brenda 2 (dy) javëve nga dorëzimi ose plotësimi i tij, në rast se ka mangësi, Banka e Shqipërisë dhe aplikuesi nënshkruajnë kontratën e pjesëmarrjes në sistemin e regjistrimit të titujve, sipas formatit tip të përcaktuar në aneksin nr.1 të rregullores.

Neni 12

Evidentimi i titujve në regjistër

Titujt që regjistrohen si të dhëna elektronike në sistemin e regjistrimit të titujve në Bankën e Shqipërisë, përmbajnë ndër të tjera edhe elementet e mëposhtme:

- a) titullin;
- b) llojin;
- c) serinë (numri i ankandit);
- d) datën e emetimit;
- e) datën e maturimit;
- f) emrin e pronarit;
- g) vlerën nominale;
- h) normën e interesit; dhe
- i) afatin dhe mënyrën e pagesës së interesit.

Neni 13

Llojet e transaksioneve me titujt në funksion të regjistrimit në llogarinë e titujve

Në funksion të regjistrimit në llogarinë e titujve, transaksionet me titujt, ndahen si më poshtë:

- a) transaksione që shoqërohen me lëvizje të vlerave monetare në llogaritë rrjedhëse që bankat kanë pranë Bankës së Shqipërisë; dhe
- b) transaksione që nuk shoqërohen me lëvizje të vlerave monetare në llogaritë rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë.

Neni 14

Evidentimi i veprimeve në llogarinë e titujve

1. Në llogarinë e titujve, në sistemin e regjistrimit të titujve evidentohen veprimet e mëposhtme:

- a) rezultatet e ankandit për emetimin e titujve në tregun primar;
- b) transaksionet me titujt në tregun sekondar, për rastet e përcaktuara në rregullore;
- c) shlyerja e vlerës nominale në datën e maturimit;
- d) shlyerja e interesit të obligacioneve në datën e kuponit; dhe
- e) regjistrimi i titullit si garanci në operacionet kredituese.

2. Banka e Shqipërisë, si rregull, kryen evidentimin e veprimeve sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, në datën e shlyerjes “T+2”.

Neni 15

Detyrimet e Bankës së Shqipërisë në lidhje me sistemin e regjistrimit

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agentit fiskal të shtetit shqiptar, krijon dhe mban sistemin e regjistrimit të titujve, si dhe ka ndër të tjera, detyrimet e mëposhtme:

a) hapjen e llogarisë së titujve në emër të pjesëmarrësit dhe/ose në emër të klientëve të tij (llogari sintetike për klientët e pjesëmarrësit), vetëm në rast se përmbushen kriteret e përcaktuara në nenet 10 dhe 11 të rregullores;

b) evidentimin e elementeve të titujve sipas nenit 12 dhe të veprimeve sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje;

c) mbrojtjen e sistemit të regjistrimit të titujve dhe të dhënat e përcaktuara në këtë sistem nga përdorimi i paautorizuar, nga ndryshimi dhe humbja;

d) sigurimin e konfidencialitetit të të dhënave të regjistruara, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse; dhe

e) ruajtjen në një vend të sigurt të dokumentacionit origjinal të përdorur për regjistrimin e të dhënave, sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

KREU IV

SHËRBIMET E KLERINGUT DHE TË SHLYERJES SË TRANSAKSIONEVE ME TITUJT

Neni 16

Klerimi dhe shlyerja e transaksioneve me titujt

1. Banka e Shqipërisë, në rolin e agentit shlyerës për transaksionet me titujt, kryen veprimet e mëposhtme:

a) klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve me titujt në tregun primar, njëkohësisht në llogaritë rrjedhëse të pjesëmarrësve në sistemin AIPS dhe në llogaritë e titujve të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve;

b) klerimin dhe shlyerjen e transaksioneve me titujt ndërmjet pjesëmarrësve në tregun sekondar, në llogaritë e titujve të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit, por pasi është kryer paraprakisht lëvizja e fondeve në llogaritë rrjedhëse të pjesëmarrësve, iniciuar nga pjesëmarrësi që blen titullin; dhe

c) evidentimin e transaksioneve me titujt ndërmjet pjesëmarrësve dhe klientëve të tyre në tregun sekondar, në llogaritë e titujve të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve, pa lëvizje të fondeve në llogaritë rrjedhëse të pjesëmarrësit.

2. Shlyerja e transaksioneve me titujt në tregun primar kryhet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjet ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 17

Ndarja e transaksioneve për efekt të klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve me titujt në tregun sekondar

Për efekt të klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve me titujt në tregun sekondar, transaksionet me titujt ndahen si më poshtë:

a) transaksione shitblerjeje midis dy pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve pranë Bankës së Shqipërisë;

b) transaksione shitblerjeje/transferimi midis pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve dhe klientëve të tyre; dhe

c) vendosje e titujve si kolateral për operacionet kredituese.

Neni 18

Transaksionet me titujt midis dy pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve

1. Regjistrimi i transaksionit të shitblerjes/transferimit bazohet në njoftimet e dërguara pranë DOM, nga pjesëmarrësi blerës dhe pjesëmarrësi shitës i titullit në datën e tregtimit (T).

2. Njoftimi, i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me instruksionet e përcaktuara në aneksin nr. 3 të rregullores dhe dërgohet pranë DOM brenda orarit zyrtar të punës.

3. Në rast se njoftimet, sipas pikës 2 të këtij neni, u referohen transaksioneve me titujt që nuk shoqërohen me lëvizje fondesh në llogaritë rrjedhëse pranë Bankës së Shqipërisë, në të dhënat nuk specifikohet çmimi.

4. Me marrjen e njoftimeve të pjesëmarrësve-palë në transaksionet me titujt, DOM bën krahasimin e njoftimeve, si dhe përputhjen e të dhënave të përcaktuara në aneksin nr. 3 të rregullores.

5. Në rast konstatimi mospërputhjes në të dhënat e njoftuara, DOM-i njofton menjëherë pjesëmarrësit, me qëllim korrigjimin e tyre. Afati më i fundit për pranimin e njoftimeve të sakta është ora 14.00 e ditës pasardhëse. Në rast të kundërt, marrëveshja për transaksionin pezullohet dhe palët njoftohen për pezullimin.

6. Në rast se nga kontrolli rezulton se ka përputhje të plotë të të dhënave, procedura vijon me verifikimin e njëkohshëm të kushteve vijuese:

a) zotërimit nga pjesëmarrësi shitës në transaksion, të titullit për të cilin është lidhur marrëveshja e shitblerjes; dhe

b) disponibilitetit të titullit për të kryer transaksione me të.

7. Nëse kushtet e përcaktuara në pikën 6 të këtij neni plotësohen, titulli bllokohet në sistemin e regjistrimit, jo më vonë se një ditë para datës së shyerjes (T+1), me qëllim transferimin e tij në datën e shyerjes. Në rast se njoftimet sipas pikës 2 të këtij neni, i referohen transaksioneve me titujt që nuk shoqërohen me lëvizje fondesh, titulli transferohet në llogarinë e pjesëmarrësit përfitues në sistemin e regjistrimit të titujve. Nëse njëri nga të dy kushtet nuk plotësohet, marrëveshja mbahet pezull deri në plotësimin e të dy kushteve dhe palët njoftohen për pezullimin.

8. DOM-i njofton pjesëmarrësit në lidhje me bllokimin e titujve sipas njoftimeve të marra në datën e tregtimit, si dhe mbi shumën e detyrimeve financiare për t'u paguar nga secili pjesëmarrës në datën e shyerjes së transaksioneve me titujt. Njoftimi bëhet jo më vonë se orari zyrtar i punës, në ditën paraardhëse të datës së shyerjes.

9. Bankat që kanë detyrim për të paguar fonde, referuar njoftimit të DOM-it, sipas pikës 8 të këtij neni, në datën e shyerjes dërgojnë urdhërtransfertat në AIPS, në formën e mesazheve SWIFT, të përcaktuar në kontratën për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve, për të debituar llogarinë e tyre dhe kredituar llogarinë e bankës përfituese, për shumën e rënë dakord në marrëveshjen e shitblerjes.

10. DOM-i verifikon në sistemin AIPS shyerjen e urdhërtransfertave për lëvizjen e fondeve në llogaritë rrjedhëse të bankave dhe në vijim, debiton llogarinë e titujve të shitësit dhe krediton llogarinë e titujve të blerësit në sistemin e regjistrimit, për vlerën e titullit të bllokuar, si dhe njofton palët për shyerjen e transaksionit të shitblerjes dhe ndryshimin e pronësisë së titullit.

11. Në rast se DOM-i konstaton se banka blerëse nuk realizon pagesën për lëvizjen e fondeve në llogarinë rrjedhëse të bankës shitëse ose nuk ka fonde të mjaftueshme për të shlyer pagesën deri në fund të ditës së shyerjes së transaksionit, transferimi i pronësisë së titullit pezullohet deri në momentin e sigurimit të fondeve të mjaftueshme, dhe palët njoftohen për arsyen e mbajtjes pezull të marrëveshjes.

Neni 19

Transaksionet me titujt ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve dhe klientëve të tyre

1. Në rast se transaksioni me titujt kryhet ndërmjet pjesëmarrësit në sistemin e regjistrimit të titujve dhe klientit të tij, regjistrimi i transaksionit me titujt bazohet në njoftimin e dërguar pranë DOM-it, në datën e shitblerjes, nga pjesëmarrësi palë në transaksionin me klientin e tij, në përputhje me instruksionet e përcaktuara në aneksin nr. 4 të rregullores. Pjesëmarrësi dërgon njoftimin pranë DOM-it, vetëm pas bërjes së vlefshme të transaksionit me klientin e tij. Në vijim të marrjes së njoftimit, DOM-i vazhdon me hapat e përshkruar në pikat 5, 6 dhe 7 të këtij neni.

2. Në rast se transaksioni me titujt kryhet ndërmjet pjesëmarrësit në sistemin e regjistrimit të titujve dhe klientit të një pjesëmarrësi tjetër në sistem, regjistrimi i transaksionit me titujt bazohet në

njoftimet e dërguara pranë DOM-it, në datën e shitblerjes, nga pjesëmarrësi palë në transaksionin me klientin e tij, si dhe nga pjesëmarrësi në rolin e regjistrarit/kujdestarit të klientit palë në transaksion, në përputhje me instruksionet e përcaktuara në aneksin nr. 5 të rregullores. Pjesëmarrësi palë në transaksion, dërgon njoftimin pranë DOM-it, vetëm pas bërjes së vlefshme të transaksionit me klientin e tij, sipas rasteve në vijim:

a) në rast se titulli transferohet nga klienti i një pjesëmarrësi të një pjesëmarrës tjetër, ky i fundit dërgon njoftimin pranë DOM-it për shlyerjen e transaksionit me titullin, si dhe te pjesëmarrësi i klientit që shet titullin, për evidentimin e transferimit të titullit në llogaritë e tij. Pjesëmarrësi i klientit që shet/transferon titullin, njofton DOM-in mbi regjistrimin e transferimit të titullit; dhe

b) në rast se titulli transferohet nga pjesëmarrësi të klienti i një pjesëmarrësi tjetër, pjesëmarrësi shitës dërgon njoftimin te DOM-i për shlyerjen e transaksionit me titullin, si dhe te pjesëmarrësi i klientit që blen titullin, për evidentimin e transferimit të titullit në llogaritë e tij. Pjesëmarrësi i klientit që blen/merr titullin, njofton DOM-in mbi regjistrimin e transferimit të titullit.

3. Njoftimet, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, dërgohen pranë DOM-it me SWIFT ose me mjete të tjera të komunikimit të sigurta, brenda orarit zyrtar të punës në datën e shlyerjes. Çdo njoftim i marrë jashtë kësaj ore konsiderohet i marrë në ditën pasardhëse të punës, duke shtyrë edhe afatet për regjistrimin e transaksioneve në llogaritë e titujve.

4. Me marrjen e njoftimeve të pjesëmarrësve për transaksionet me titujt, sipas pikës 2 të këtij neni, DOM-i bën krahasimin për përputhjen e të dhënave të përcaktuara në aneksin nr. 5 të rregullores. Në rast konstatimi mospërputhjes në të dhënat e njoftuara, DOM-i njofton menjëherë pjesëmarrësit. Afati më i fundit për pranimin e njoftimeve të sakta është orari zyrtar i punës në datën e shlyerjes. Në rast të kundërt, kërkesa për transferimin e titullit pezullohet dhe palët njoftohen për pezullimin.

5. Në rast se nga kontrolli, rezulton se ka përputhje të plotë të të dhënave, procedura vijon me verifikimin e zotërimit/disponibilitetit nga pjesëmarrësi të titullit për të cilin është lidhur marrëveshja e shitblerjes/transferimit.

6. Në rast se DOM-i konstaton se pjesëmarrësi shitës/transferues nuk zotëron sasinë e nevojshme të titujve për të shlyer transaksionin deri në fund të ditës së shlyerjes, transferimi i pronësisë së titullit mbahet pezull, deri në momentin e disponimit të titujve dhe palët njoftohen për arsyen e pezullimit të regjistrimit.

7. Në rast se kushti i përcaktuar në pikën 5 të këtij neni plotësohet, DOM-i vijon me evidentimin e transaksionit në sistemin e regjistrimit të titujve, duke debituar llogarinë e titujve të pjesëmarrësit ose llogarinë e titujve të klientëve të pjesëmarrësit, në rolin e palës shitëse në transaksion, si dhe duke kredituar llogarinë e titujve të pjesëmarrësit ose llogarinë e titujve të klientëve të pjesëmarrësit, në rolin e palës blerëse, për vlerën nominale të titullit të përcaktuar në njoftimet për transferim të pronësisë së titullit, si dhe njofton palët për ndryshimin e pronësisë së titullit.

Neni 20

Vendosja e titujve si kolateral për operacionet kredituese ndërmjet bankave pjesëmarrëse në sistemin e regjistrimit të titujve

1. Në rastet kur titujt përdoren si kolateral për operacionet kredituese në treg, bankat njoftojnë DOM-in me qëllim bllokimin e titullit në sistemin e regjistrimit të titujve, në favor të huadhënësit/marrësit të kolateralit. Nëse DOM-i konstaton se dhënësi nuk e zotëron titullin, refuzon kërkesën për regjistrim të kolateralit dhe njofton palët për pezullimin.

2. Njoftimet, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen respektivisht nga huamarrësi/dhënësi i kolateralit dhe huadhënësi/marrësi i tij, jo më vonë se orari zyrtar i punës në datën e marrëveshjes së kolateralit dhe përmban të dhënat e përcaktuara në aneksin nr. 6 të rregullores.

3. Pas verifikimit të përputhshmërisë së plotë të të dhënave në njoftimet e palëve, DOM-i kryen bllokimin e titullit, për vlerën nominale të tyre, në një llogari të posaçme në favor të marrësit të kolateralit dhe njofton palët. Regjistrimi, ndër të tjera, përmban datën e vendosjes së titullit si

kolateral dhe datën e përfundimit të marrëveshjes.

4. Në rastet kur ka mospërputhje ndërmjet të dhënave, DOM-i njofton palët për të kryer rregullimet përkatëse dhe pezullon regjistrimin e kolateralit derisa palët e përfshira në operacion të bien dakord për instruksionet e njoftimit.

5. Në datën e përfundimit të marrëveshjes për vendosjen e kolateralit, DOM-i liron titullin e vendosur si kolateral, duke e kthyer atë në gjendjen e mëparshme në llogarinë e titujve të dhënësit, vetëm nëse të dyja palët e përfshira në marrëveshje njoftojnë DOM-in mbi përfundimin e marrëveshjes dhe lirimin e titullit të vendosur si kolateral. Në mungesë të njoftimit nga palët, zbatohen procedurat ligjore dhe nënligjore në fuqi në lidhje me kolateralin financiar.

Neni 21

Mënyra e komunikimit

Njoftimet, sipas pikave 2, 5, 7, 8, 10 dhe 11 të nenit 18, pikave 1, 2, 4,6 dhe 7 të nenit 19 dhe pikave 1, 3, 4 dhe 5 të nenit 20 të kësaj rregulloreje, dërgohen pranë DOM-it me SWIFT ose me mjete të tjera të komunikimit të sigurta, sipas përcaktimit përkatës të kontratës për pjesëmarrje në sistemin e regjistrimit të titujve.

Neni 22

E drejta për të pezulluar regjistrimin e veprimeve të pjesëmarrësit

1. Banka e Shqipërisë ka të drejtë ta pezullojë regjistrimin e veprimeve të kryera nga pjesëmarrësi (bankë) në tregun sekondar, në rast se ky i fundit në mënyrë të përsëritur nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga pjesëmarrja e tij në sistemin e regjistrimit të titujve.

2. Vendimi për pezullimin e regjistrimit të veprimeve të pjesëmarrësit në tregun sekondar merret nga drejtori i DOM-it dhe duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme.

3. Kohëzgjatja e periudhës së pezullimit, si rregull nuk duhet të jetë më shumë se 4 (katër) muaj.

4. DOM-i njofton menjëherë bankat e tjera për vendimin e pezullimit të regjistrimit të veprimeve ndaj një pjesëmarrësi të caktuar (bankë) në tregun sekondar.

Neni 23

Transaksionet me titujt ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe bankave

Klerimi dhe shlyerja e transaksioneve me titujt në sistemin e regjistrimit, për të gjitha llojet e transaksioneve që Banka e Shqipërisë kryen me bankat, kryhet në përputhje me dispozitat e këtij kreu, përsa kohë nuk bie ndesh me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, në zbatim të politikës monetare.

KREU V

RAPORTIMI I INFORMACIONIT TË SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË TITUJVE

Neni 24

Pasqyra e llogarisë së titujve për pjesëmarrësit në sistemin e regjistrimit

1. Banka e Shqipërisë vë në dispozicion të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve, pasqyrën me të dhëna të hollësishme mbi titujt në zotërim të tyre, si rregull çdo muaj, si dhe në çdo rast kur kërkohet nga pjesëmarrësi.

2. Banka e Shqipërisë nuk mban komisione për lëshimin e pasqyrës, së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Afati maksimal për vënien në dispozicion të pasqyrës sipas pikës 1 të këtij neni, është data 10 e çdo muaji. Pasqyra e llogarisë së titujve përfshin, ndër të tjera edhe të dhënat e mëposhtme:

a) titujt në zotërim;
b) titujt disponibël për transaksione;
c) titujt të vënë si garanci; dhe
d) totalin e titujve sipas grupimeve “persona fizikë” dhe “persona juridikë”, në rastet kur pjesëmarrësi është i licencuar për të kryer veprimtari tregtimi me titujt.

4. Në rast mospërputhjeje ndërmjet të dhënave të mbajtura nga Banka e Shqipërisë në llogarinë e titullit të pjesëmarrësit me ato të mbajtura nga vetë pjesëmarrësi, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e pasqyrës sipas pikës 3 të këtij neni, pjesëmarrësi raporton pranë DOM-it mospërputhjet e evidentuara. DOM-i kryen kontrollet dhe verifikimet përkatëse, si dhe mban kontakte me personat përgjegjës të pjesëmarrësve, deri në saktësimin dhe përputhjen e informacionit midis palëve. Çdo korrigjim i nevojshëm në llogarinë e titullit, dokumentohet.

Neni 25

Bashkëpunimi me Autoritetin

Banka e Shqipërisë, brenda datës 10 të çdo muaji, vë në dispozicion të Autoritetit të dhënat e rezultuara në fund të muajit paraardhës, në lidhje me llogarinë e titujve të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve.

Neni 26

Dispozitë e fundit

Anekset me numrat nga 1 deri në 6 janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

ANEKSI NR. 1 KONTRATA TIP

PËR PJESËMARRJE NË SISTEMIN E REGJISTRIMIT TË TITUJVE

Palët:

Banka e Shqipërisë, në cilësinë e Administratorit të sistemit të regjistrimit të titujve të shtetit, me adresë: sheshi “Skënderbej”, nr.1, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar në këtë kontratë nga zoti Marian Gjermani, Drejtor i Departamentit të Operacioneve Monetare,

dhe

_____, në cilësinë e pjesëmarrësit, me adresë zyre në _____, me (licencë _____), përfaqësuar në këtë kontratë nga zonja /zoti _____ lindur më _____, në datë _____, me numër pasaporte/letërnjoftimi _____

Duke qenë se:

1. Në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe marrëveshjes ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Banka e Shqipërisë është agjent fiskal i qeverisë.

2. Në bazë të nenit 31 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë së Republikës së Shqipërisë”, Banka e Shqipërisë, në cilësinë e agjentit fiskal të qeverisë, krijon, mban sistemin e regjistrimit në llogari për titujt e shtetit, si edhe mbështet krijimin e tregut sekondar të titujve të shtetit duke lehtësuar përdorimin e sistemit të regjistrimit, dhe

3. Në bazë të nenit 11 të vendimit nr. _____, datë _____ 2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë “Për miratimin e rregullores “Për transaksionet me titujt ndërmjet bankave dhe funksionimin e sistemit të regjistrimit të titujve”” (më poshtë për thjeshtësi referuar si “Rregullorja”), subjekti që dëshiron të marrë pjesë në sistemin e regjistrimit të titujve, pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje, duhet të lidhë kontratën e pjesëmarrjes në sistemin e regjistrimit të titujve me Bankën e Shqipërisë, e cila e krijon dhe e mban këtë sistem.

Bien dakord të lidhin këtë kontratë sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të Administratorit, i cili në rolin e tij si agjent fiskal i qeverisë, krijon dhe mban sistemin e regjistrimit të titujve të shtetit, si dhe i të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësit që do të ketë llogari të titujve në këtë sistem, në emër të vet dhe/ose në emër të klientëve të tij (llogari sintetike për klientët e pjesëmarrësit).

Neni 2

Baza ligjore

Kjo kontratë hartohet në bazë të neneve 659 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe rregullores së Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

Përkufizime dhe interpretime

1. Termat e përdorur në kontratë kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në rregullore.

2. Çdo kusht ose dispozitë e kontratës, që mund të sjellë paqartësi interpretohet në kontekstin e rregullores dhe në këndvështrimin e qëllimit për të cilin palët lidhin këtë kontratë.

3. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë kontratë, aplikohen dispozitat e rregullores dhe në rast se këto të fundit nuk rregullojnë çështje të veçanta, aplikohen aktet ligjore dhe nënligjore të fushës.

Neni 4

Dokumentacioni bashkëlidhur

Kërkesa për aplikim, së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas nenit 10 të rregullores, të dorëzuara nga pjesëmarrësi, i bashkëlidhen kontratës dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 5

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj për një kohë të pacaktuar.

Neni 6

Mjeti dhe format e komunikimit

1. Për dërgimin/marrjen e urdhërtransfertave në lidhje me transaksionet me titujt e shtetit në tregun sekondar, pjesëmarrësi përdor si mjet komunikimi _____.

2. Administratori, në përputhje me mjetin e komunikimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, detajon specifikimet teknike të komunikimit për secilin rast, sipas një shtojce të veçantë (Format e komunikimit), që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Neni 7

Detyrimet dhe të drejtat e Administratorit

1. Administratori i sistemit të regjistrimit të titujve të shtetit, ka detyrimet e mëposhtme:

a) hap llogari titujsh në emër të pjesëmarrësit dhe/ose në emër të klientëve të tij;

b) evidenton në sistem titujt në formën e të dhënave elektronike, sipas nenit 12 të rregullores;

c) evidenton transaksionet me titujt, sipas përcaktimeve të nenit 14 të rregullores, si rregull në datën e shlyerjes “T+2”;

d) mbron sistemin e regjistrimit të titujve dhe të dhënat e tij nga përdorimi i paautorizuar, nga ndryshimi dhe humbja;

e) merr masat e nevojshme për sigurimin e konfidencialitetit të të dhënave të regjistruara, sipas ligjeve dhe akteve nënligjore përkatëse;

f) ruan në një vend të sigurt dokumentacionin origjinal të përdorur për regjistrimin e të dhënave, sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi;

g) vë në dispozicion të pjesëmarrësit pasqyrën me të dhëna të hollësishme mbi titujt në zotërim të tij, si rregull brenda datës 10 të çdo muaji, si dhe në çdo rast kur kërkohet prej tij sipas përmbajtjes së përcaktuar në nenin 24 të rregullores;

h) klonon dhe shlyen transaksionet me titujt në tregun primar, njëkohësisht në llogarinë rrjedhëse të pjesëmarrësit në sistemin AIPS dhe në llogarinë e titujve në sistemin e regjistrimit të titujve;

i) klonon dhe shlyen transaksionet me titujt ndërmjet pjesëmarrësve në tregun sekondar, në llogaritë e titujve të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit, por pasi është kryer paraprakisht lëvizja e fondeve në llogaritë rrjedhëse të pjesëmarrësve, iniciuar nga pjesëmarrësi që blen titullin;

j) evidenton transaksionet me titujt ndërmjet pjesëmarrësve dhe klientëve të tyre në tregun sekondar, në llogaritë e titujve të pjesëmarrësve në sistemin e regjistrimit të titujve, pa lëvizje të fondeve në llogaritë rrjedhëse të pjesëmarrësit;

k) informon menjëherë pjesëmarrësit e tjerë në rast se vendos për pezullimin e ndonjë prej pjesëmarrësve, sipas nenit 22 të rregullores; dhe

l) çdo detyrim tjetër të përcaktuar në rregullore.

2. Administratori i sistemit të regjistrimit të titujve të shtetit, ka të drejtat e mëposhtme:

